



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 8, datë 20.11.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI DHE HOTEL, 1, 11, 12, 13 DHE 14 KATE ME 2 KATE DHE 3 KATE
PARKIM NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “SELITA E VJETËR”,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “ERE Architecture & Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe hotel, 1, 11, 12, 13 dhe 14 kate me 2 kate dhe 3 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Selita e Vjetër”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërisë “ERE Architecture & Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi Nr. 12, datë 05.04.2024 Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi dhe hotel, 1, 11, 12, 13 dhe 14 kate me 2 kate dhe 3 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Selita e Vjetër”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërisë “ERE Architecture & Construction” sh.p.k, shfuqizohet.

garkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26.03 / 2025